



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u mbështetur në nenin 12 dhe 17 paragrafi 1 nën shkronjën c dhe f) si dhe nenin 40 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale 03/L-040. Dispozitat e Ligjit nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme si dhe dispozitave të ligjit Nr.04/-04-L-013 Ligji për Kadastër.Nenit 10 dhe 40 të Statutit të Komunës, me kërkesën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjente 01nr463-4342/2022 të datës 09/02/2022 si dhe me rekomandimin e Komitetit për Politik dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e I-rë të rregullt të mbajtur më datën 25.02.2022, merr këtë:

V E N D I M

Për

Shpallje “Zonë me Interes Publik” parcelën me nr.P-71010080-00109-4, ZK Çabiq

1. Miratohet kërkesa për Shpalljen “Zonë me Interes Publik” parcela nr.P-71010080-00109-4 me sipërfaqe prej 1527m² ZK Çabiq, pronë private në emër të znj. Zelfije Milazim Bashotaj.
2. Vendimi si në pikën 1(një) behët me qëllim të ndërtimit të rezervuarit akumulues për furnizim me ujë të pijshëm me kapacitet 1000 m3(kub) ujë dhe vazhdimin të procedurave tjera ligjore deri në finalizimin e projektit.
3. Kompetent për vazhdimin e procedurave lidhur me shpronësimin e parcelës se lartcekur është kryetari i komunës në bashkëpunim me drejtorinë e shërbimeve Publike dhe emergjente dhe drejtorin për kadastër, gjeodezi dhe pronësi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
5. Me këtë vendim njoftohet: MPL, Kryetari i Komunës, Titullari i pronës, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Zyra për informim dhe Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr 06-7065 /2022
Klinë, me 04.03 /2022



Kryesuesi,
Fadil GASHI